



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 18.10. 2016, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Fadil Demaku, nënkryetar i parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami Nuredin Ibishi dhe Zafir Berisha, anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Zyrtarët nga Policia e Kosovës: Naim Rexha, zëvendës drejtor i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blend Zyrapi-KIPRED, Gent Gjikoili-KIPRED, Luanda Domi-DCAF, Milot Rexhepi-DCAF dhe Naim Hajdari-EULEX.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtur më 15.9.2016;
3. Raportimi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni;
4. Të ndryshme.

Daut Haradinaj, kryetar, fillimisht theksoi që Komisioni e ka ftuar për të raportuar drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, rreth arrestimit të z. Nehat Thaçi, por në mungesë të

drejtorit të përgjithshëm, është z.Naim Rexha, zëvendës drejtori i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Arsyeja e këtij takimi është njohja me masat e marra nga Policia e Kosovës, nëse Policia e Kosovës ka listën e personave të përndjekur nga organet serbe dhe aspekte të tjera.

Naim Rexha, zëvendës drejtor i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, fillimisht theksoi që z.Shpend Maxhuni nuk pati mundësi të jetë objektivist në raportim. Sa i përket z.Nehat Thaçi, bëri të ditur se rreth orës 00:10, në stacionin e Policisë Kufitare Dheu i Bardhë, në hyrje nga Republika e Serbisë, një person ka paraqitur rastin e arrestimit të nënkolonel Nehat Thaçit, pasi i njëjti person në udhëtim privat ka kaluar pikën e kontrollit të Policisë Kufitare të Republikës së Kosovës.

Pas marrjes së informacionit, stacioni policor në Dheun e Bardhë ka informuar qendrën kufitare rajonale dhe më pas Qendra Operative Koordinuese dhe Komunikuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës. Me këtë rast është njoftuar menaxhmenti i lartë i Policisë së Kosovës dhe është informuar ministri i Punëve të Brendshme si dhe përfaqësuesi i EULEX-it. Sipas dëshmimeve të dëshmitarit, rreth orës 20:00, të datës 28 shtator, nënkoloneli Thaçi ka kaluar kufirin dhe ka qenë në pushim të autorizuar nga shërbimi në kohëzgjatje prej pesë ditëve dhe sipas familjarëve ka planifikuar vizitë tek të afërmit në Gjermani dhe Zvicër. Ai ka qenë me rroba civile dhe veturë private, me gjasë duke udhëtuar transit përmes Republikës së Serbisë. Pas identifikimit dhe gjetjes së një “urdhërarresti” për të dhe që daton nga muaji shtator i vitit 2010, gjoja ka të bëjë për “veprën penale të terrorizimit, të pretenduar të kryer në vitin 1999”. Më pas, z.Thaçi është dërguar në burgun e Nishit, rreth orës 01:25 dhe të nesërmen është dërguar para gjyqtarit në Beograd dhe pas seancës gjyqësore është vendosur në masën e sigurisë së paraburgimit prej tridhjetë ditësh.

Policia e Kosovës pas marrjes së informacionit të verifikuar, vazhdon të mbajë kontakte të rregullta me familjarët e z.Thaçi dhe kontribuon në dhënien e shënimeve për aq sa posedon. Ndërsa, sa i përket shkrimeve në disa media, se Policia e Kosovës ua ka ndaluar zyrtarëve të saj kalimin përmes territorit të Serbisë, tha se nuk është bërë një gjë e tillë, pasi të gjithë zyrtarët policorë gëzojnë të drejtën e lëvizjes.

Mosqenia pjesë e INTERPOL-it është si mangësi për posedimin të listave, duke theksuar se ky arrestim ka pasuar nga vendimi i organeve të Republikës së Serbisë dhe duke u nisur nga rrethanat që qytetarët e Kosovës i konsiderojnë si “qytetarë të shtetit serb”, ka pasuar vendimi dhe ka qenë e pamundur të posedohet informacion për këtë çështje. Pas arrestimit, autoritetet serbe kanë njoftuar UNMIK-un në Kosovë dhe pastaj UNMIK-u e ka njoftuar Policinë e Kosovës, pastaj Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Jashtme, kurse i është bërë kërkesë institucioneve të EULEX-it për të ndikuar në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet dhe të lirohet z.Nehat Thaçi nga masa e paraburgimit.

Daut Haradinaj, pyeti se a është hera e parë që z.Nehat Thaçi e ka kaluar kufirin? A ka qenë i informuar që është në listën e personave të kërkuar? Nëse po, pse ka udhëtuar përmes Serbisë? A është informuar zyra ndërlidhëse e Kosovës në Beograd? A është kërkuar nga Policia e Kosovës që INTERPOL-i të bëjë pastrimin e listave?

Fadil Demaku, pyeti se duke qenë se Policia e Kosovës zbaton parimet e përgjithshme, sa zbatohen këto parime nga Ministria e Punëve të Brendshme? A janë të obliguar oficerët e lartë të policisë, që edhe gjatë kohës së pushimit, të informojnë eprorët për vendin se ku ndodhen? Sa jemi të sigurt që të mos krijohen precedentë për zyrtarë të lartë të Kosovës nga ana e shtetit serb?

Anton Quni, pyeti se sa është funksional Ligji i Policisë, ndërsa duke iu referuar praktikave të mira të shteteve, për zyrtarët e lartë të fushës së sigurisë, pyeti se si është e rregulluar brenda Policisë së Kosovës? A ka obligim të njoftojë për lëvizjet, numrin e kontaktet? A jepen udhëzime për shtete specifike, nëpër të cilat do të kalojnë zyrtarët policorë? A është e rregulluar kjo fushë?

Rexhep Selimi, duke iu referuar fjalës së z.Naim Rexha, që njoftimin e parë për arrestimin e z. Nehat Thaçi e kanë marrë nga një qytetar që vinte nga Serbia për në Kosovë, pyeti:ku është menaxhimi i integruar i kufijve që ka qenë pjesë e marrëveshjeve?

Duke iu referuar fjalës së z.Rexha, që z.Thaçi kishte për destinim Gjermaninë dhe Zvicrën, tha se a ekziston ndonjë e dhënë e protokolluar që z.Thaçi ka qenë duke shkuar në shtetin gjerman apo zviceran? Ndërsa, paraqitjen si problem të mosanëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, Selimi tha se e konsideron që nuk është arsyetim, pasi Kosova mund të marrë informacione përmes shteteve që janë anëtarë të INTERPOL-it me të cilat Kosova ka raporte të mira...

Nuredin Ibishi, pyeti si është bashkëpunimi mes Policisë së Kosovës dhe institucioneve të sigurisë, a janë të kënaqur me këtë bashkëpunim? A është mundësia të gjendet bashkëpunim me shtetet që e kanë njohur Kosovën për informacionet në INTERPOL? A është në fuqi ende marrëveshja mes Policisë së UNMIK-ut dhe Policisë së Serbisë për luftimin e krimit të organizuar? Si është vija e komunikimit mes Policisë së Kosovës dhe UNMIK-ut? Çfarë është ndërmarrë për plotësimin e udhëzimeve administrative, me qëllim që zyrtarët policorë të njoftojnë për udhëtimet e tyre?

Qerim Bajrami, theksoi se nga Grupi Parlamentar 6+, është përkrahja e plotë për ndërmarrjen e hapave nga Policia e Kosovës për lirin e z.Nehat Thaçi dhe theksoi që ky arrestim ka qëllim politik pasi shteti serb, si duket ka blerë kohë për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për lirin e tij.

Zafir Berisha, duke iu referuar fjalës së z.Naim Rexha, se Policia e Kosovës është duke mbajtur kontakte me familjen, pyeti se a ka nevojë për ndihmë financiare z.Nehat Thaçi?

Ganimete Musliu, pyeti se a ka Policia e Kosovës listë të personave, të cilët kanë bërë krime në Kosovë? Pasi jo rrallë ka ndodhur që persona të tillë vijnë në Kosovë dhe me procedurë të shpejtë lirohen, siç ishte rasti me gjeneralin serb Bojoviq, i cili sipas dëshmive, thuhet se është përgjegjës për vrasjen e 499 personave në rajonin e Llapit.

Naim Rexha, zëvendës drejtor i drejtorit të përgjithshëm të Policisë, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga deputetët, tha se Policia e Kosovës është e gatshme për të dhënë përgjigjeje. Në përgjigjen nëse z. Thaçi ka kaluar apo jo kufirin, theksoi që sipas kontrollit të sistemit në të gjitha pikat e kontrollit kufitar nuk rezulton që z.Thaçi të ketë shkuar në Serbi, asnjëherë.

Daut Haradinaj, shtoi se nga ana e z.Bojan Mitiq, është thënë që z.Nehat Thaçi ka kaluar kufirin më shumë se njëherë, dhe kjo ka lënë të nënkuptohet që shteti serbe e ka arrestuar politikisht.

Naim Rexha, theksoi që shënimet që posedojnë nuk tregojnë që z.Thaçi e ka kaluar kufirin dhe është futur në territorin e Serbisë. Sipas njohurive që ka poseduar Policia e Kosovës, ai nuk ka qenë në listën e personave të kërkuar. Më tutje theksoi se Zyra Ndërlidhëse e Kosovës në Beograd është informuar menjëherë për rastin. Ndërsa, sa i përket takimit të realizuar në Beograd në mes të drejtorëve të policisë së Kosovës dhe Serbisë, ka qenë i mbështetur nga EULEX-i dhe ka qenë në suaza të bashkërendimit të aktiviteteve për luftimin e krimit, por nuk ka bashkëpunim të mirëfilltë policor me Republikën e Serbisë.

Sa i përket pastrimit të listave të të kërkuarve dhe pengesës së mosanëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, Rexha theksoi që është një dallim mes listave që posedon ky mekanizëm dhe shtetet veç e veç. Republika e Kosovës nuk ka atashe policor në Republikën e Serbisë, ndërsa sa i përket çështjes së zbatimit të parimeve të përgjithshme, theksoi që në kuadër të policisë është Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar, e cila aktivitetin e ka të shtrirë në komunikim me zyrat e ngjashme në shtetet e rajonit dhe më gjerë, dhe i është shkruar homologut në Beograd por nuk ka pasur përgjigjeje.

Sa i përket çështjes së udhëtimit, të gjithë zyrtarët policorë gëzojnë lirinë e lëvizjes, por janë të obliguar të plotësojnë formularin dhe shënimet për kërkesë të eprorit të parë, para se të aprovohet apo jo pushimi. Me këtë kërkesë caktohet koha pushimit dhe vendi ku do ndodheni si dhe numrat e kontaktit, ndërsa z.Thaçi ka kërkuar pushim nga data 26 deri më 30 shtator dhe ka treguar për vendqëndrimin, por jo edhe nga do të shkojë.

Të gjithë zyrtarëve të policisë iu është sugjeruar që të shmangin udhëtimin përmes Serbisë, por nuk i është ndaluar, ashtu siç është paraqitur në media. Duke qenë se janë dy opinione nëse ka shkuar më herët apo jo, Rexha theksoi se nuk kanë evidencë të tillë, ndërsa sa i përket Ligjit të Policisë, tha se ai është funksional dhe garanton autonominë operacionale të Policisë së Kosovës, gjithashtu edhe udhëzimet administrative dhe rregulloret që burojnë nga ligji, rregullojnë dhe sanksionojnë aspektet e punës së policës.

Edhe me rastin e organizimeve sportive, nga ana e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Serbisë, kërkohen informacione ndërsa për rastin e ndodhur nuk është ofruar asnjë informacion, kurse sa i përket dëshmisë së qytetarit, ajo është konfirmuar dhe verifikuar me palën serbe në pikën e kalimit kufitar.

Rexhep Selimi, pyeti se a është vlerësuar e nevojshme nga Policia e Kosovës çështja e ndërtimit të legjislacionit sekondar, i cili obligon zyrtarët policorë, jo vetëm të tregojnë destinacionin e fundit por edhe të informojnë eprorët se ku do të jenë? Shteteve të cilave iu referohemi si modele, a zbatohet rregulla që të njoftojë dhe ku do të jetë?

Naim Rexha, vlerësoi se kjo çështje është e rregulluar mirë në Policinë e Kosovës, ku parashihet që çdo zyrtarë duhet të marrë leje, arsyen dhe vendndodhjen. Ndërsa, sa i përket aspektit të menaxhimit të integruar të kufirit, ai theksoi se gjendja aktuale është kjo që është në realitet, ndërsa sa i përket bashkëpunimit me institucionet e sigurisë, theksoi se ekziston bashkëpunimi i mirë. Në disa fusha ka memorandume të bashkëpunimit me institucionet e sigurisë, ndërsa marrëveshja mes UNMIK-ut dhe Serbisë për Policinë e Kosovës është e pavlefshme, ndërsa komunikimi i fundit ka mbetur nga kontaktet e mëhershme, por Policia e Kosovës nuk mban takime dhe as kontakte me UNMIK-un.

Ndërsa, sa i përket mundësisë së lirimit të tij, vlerësoi se është çështje juridike dhe nuk mund të supozojmë. Sa i përket familjes së z.Nehat Thaçi, Rexha theksoi që aktualisht nuk ka nevojë për

ndihmë, kurse sa i përket listës së personave që kanë bërë krime në Kosovë, theksoi se është ekskluzivisht në mandatin e policisë së EULEX-it dhe se Policia e Kosovës është shprehur e gatshme të marrë edhe këtë përgjegjësi, por ajo ende është në kompetencë të EULEX-it.

Ganimete Musliu, pyeti se a është regjistruar z.Nehat Thaçi në kufirin e Kosovës? Duke qenë se z.Thaçi e ka marrë pushimin nga data 26 deri më 30 shtator, ndërkohë që është arrestuar me datën 29 shtator, dhe një ditë e mbetur pushim, si shpjegohet kjo?

Naim Rexha, theksoi që llogaritja e pushimit bëhet në ditë pune, ndërsa kufirin e Kosovës e ka kaluar në orën 20:10.

Daut Haradinaj, vlerësoi që kontribut i gjithsecilit për lirimin e z.Thaçi është i kufizuar, por që kushtëzimi i dialogut me Beogradin deri në lirimin e z.Thaçi do të ishte i drejtë.

Fadil Demaku, ngriti çështjen e një sulmi që ka ndodhur në një lojë futboll, ku gjyqtari është goditur me guri, duke shtuar që edhe pse pjesëtari i policisë ka qenë i pranishëm, nuk ka ndërmarrë asgjë dhe pyeti se si trajtohet një veprim i tillë nga Policia e Kosovës?

Naim Rexha, tha se sa i përket rastit në fjalë, do të konfirmohet, duke shtuar që zyrtari policor duhet të respektojë dhe zbatojë autorizimet policore.

Rexhep Selimi, tha se sipas raportit të Amnesty International, i cili i është dërguar ministrit të Punëve të Brendshme, z.Skender Hyseni, më 29 shkurt 2016, është konstatuar që ka ndodhur përdorim i tepruar i forcës, me rastin e intervenimit në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje më 28 nëntor 2015. Ndaj sa policëve është marrë masë në këtë rast? Për shkak të përdorimit të forcës së tepruar, është ngritur kallëzim penal, ndaj dy zyrtarëve policorë, për përdorimin e forcës së tepruar, një veterani të luftës, i cili më 17.11.2015, ka qenë në vendin e punës dhe është përdorur dhunë e paarsyeshme. Ju lutem të njoftohemi për rastet e përmendura, çfarë është ndërmarrë për zyrtarët policorë?

Naim Rexha, theksoi se z. Selmi, për të dy pyetjet, do të marrë përgjigje me shkrim.

Qerim Bajrami, pyeti lidhur me zhdukjen e një qytetari malazez, i cili është i lindur në Kosovë, z.Ismet Kanizha, i cili ka nëntë muaj që nuk dihet asgjë për fatin e tij. A ka informacione?

Naim Rexha, në përgjigje të pyetjes së z.Bajami, theksoi që nuk ka avancim në rastin e përmendur, por që do të pranojë përgjigje me shkrim.

Sqarim:Komisioni ka vazhduar takimin për 10 minuta me dyer të mbyllura.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj